



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2464 Prot.

Tiranë, më 12.12.2025

VENDIM

Nr. 369, datë 05.12.2025

**“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM SARANDË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar (në mungesë)

Në mbledhjen plenare të datës 05.12.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2464 prot., datë 06.10.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë,

disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Me Vendimin nr. 65, datë 10.04.2025, *“Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit ***, me detyrë Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë”*, Këshilli ka vendosur ndër të tjera, edhe dhënien e masës disiplinore plotësuese *“Largim nga detyra e kryetarit”*, ndaj magjistratit ****.
3. Me Vendimin nr. 2759/2, datë 05.12.2024, *“Për komandimin e Zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë”*, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është vendosur caktimi i prokurores Silvana Belishta në detyrën si Zëvendësdrejtues të kësaj zyre të Prokurorisë, deri në datën 04.12.2025.
4. Më parë, në datë 11.09.2025, Këshilli ka shpallur procedurën për plotësimin e vendit vakant për drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.
5. Me Vendimin nr. 316, datë 16.10.2025, *“Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës për ngritjen në detyrë në pozicionin vakant për Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, të shpallur me Vendimin nr. 285, datë 11.09.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka vendosur përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës për ngritjen në detyrë në pozicionin vakant për drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, të shpallur me Vendimin nr. 285, datë 11.09.2025, të Këshillit, për shkak të mungesës së kandidatëve për këtë pozicion.
6. Për të siguruar vijueshmërinë e punës bëhet i domosdoshëm plotësimi i përkohshëm këtij vendi vakant me qëllim garantimin e funksionalitetit normal të kësaj zyre të prokurorisë.
7. Sipas Relacionit të cituar më sipër, anëtari i Komisionit, z. Sokol Stojani ka propozuar që magjistratja, Violeta Shkurta, aktualisht me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë Fier, të caktohet përkohësisht në funksionin e drejtuesit të zyrës së Prokurorisë Sarandë, për një afat 3 (tre) muaj, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019, *“Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”*, e ndryshuar.
8. Sipas të njëjtit Relacion, dy anëtarët e tjerë të Komisionit mbajtën qëndrime të ndryshme përsa i takon plotësimit të vendit vakant si drejtues në zyrën e Prokurorisë Sarandë. Kryetarja e Komisionit dhe anëtari, znj. Mirela Bogdani mbajti qëndrimin që në këtë pozicion të caktohet përkohësisht drejtuesi aktual i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë Gjirokastër, z. Petrit Çano. Sipas saj, me përvojën e gjatë në sistemin e prokurorisë z. Çano do të mundësojë mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në zyrën e Prokurorisë Sarandë.

Ndërsa, anëtari tjetër i Komisionit, znj. Ledina Riza kishte mbajtur qëndrimin që, plotësimi i këtij vendi vakant të bëhet përmes aplikimit të instrumentit të transferimit me pëlqim të prokurorëve, sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe Rregullore.

9. Zbatimi i mekanizmit të caktimit të përkohshëm për plotësimin e vakancës në fjalë parashikohet në kuadrin normativ, si vijon:

i. Neni 42, pika 2, i Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion”;

ii. Neni 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

a) caktimit në pozicione të tjera;

b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji”;

.....

4. Këshilli merr vendim për rastet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe përcakton datën e fillimit dhe datën e mbarimit të periudhës kohore, në të cilën pozicioni mund të plotësohet përkohësisht.”

iii. Neni 3, i Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, e ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër”.

10. Pas diskutimeve sa më sipër në mbledhje plenare mes anëtarëve të Këshillit, për shkak të nevojës së shpejtë për plotësimin e këtij funksioni dhe mbarëvajtjen e punës në këtë zyrë të Prokurorisë, anëtari, znj. Ledina Riza propozoi që të vijohet me caktimin e përkohshëm të një prokurori të kësaj zyre në detyrën e drejtuesit të saj dhe, menjëherë më pas, Këshilli të vijojë me shpalljen e procedurës për transferimin e përkohshëm me pëlqim të një prokurori në këtë zyrë të Prokurorisë. Ky propozim i znj. Riza, u mbështet edhe nga anëtari tjetër i Komisionit, znj. Mirela Bogdani.

11. Propozimet e mësipërme të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës lidhur me mënyrën e plotësimit të vendit vakant të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë iu nënshtruan votimit të anëtarëve në mbledhjen plenare të Këshillit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika

8, 166, 184, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, si dhe nenin 3, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Silvana Belishta në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për një periudhë deri në 3 (tre) muaj.
2. Për periudhën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, prokurori Silvana Belishta të paguhet me pagën e pozicionit ku është caktuar përkohësisht.
3. Të njoftohen me këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë dhe prokurori Silvana Belishta.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 05.12.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani
(kundër)

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj
(kundër)

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda
(kundër)

ANËTAR
Erind Merkuri
(kundër)

ZV/KRYETAR
Erind Germenji
(kundër)

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka